

Si duhet të aplikojmë për përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore?

Përjashtimi nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore jepet në bazë të një kërkesë që hartohet sipas formularit të kërkesës që gjendet në linkun si më poshtë:

<https://www.drejtesia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/>

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet:

- së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore (këshillimi, përfaqësimi dhe mbrojtja para gjykatës;
- bashkëlidhur kërkesëpadisë;
- në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur procesi gjyqësor.

Kërkesa mund të paraqitet nga vetë personi që gëzon këtë të drejtë, por edhe nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së parë. Ajo paraqitet personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel. Për më shumë informacion ju mund të vizitoni faqen online të **Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas** në linkun: <https://ndihmajuridike.gov.al/>

Gjithashtu, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka vendosur në dispozicion të publikut një numër të gjelbër pa pagesë **0800 10 10** dhe një sistem online **“Juristi Online”** nga ku mund të kërkon informacion.



PËRJASHTIMI NGA TARIFAT DHE SHPENZIMET GJYQËSORE

KUSH DHE SI MUND TË PËRFITOJË?



Kjo fletëpalosje u hartua në bashkëpunim me Institutin Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra ALTRI), me mbështetjen financiare të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.



Çfarë është tarifa gjyqësore?

Është një pagesë që palët në një proces gjyqësor kryejnë nëpërmjet administratës gjyqësore në favor të administratës tatimore.

- Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesëpadisë përlogaritet mbi bazën e vlerës së padisë për çështje gjyqësore civile dhe administrative;
- Tarifa gjyqësore shtesë caktohet në rastet kur pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykim e çështjes;
- Tarifa gjyqësore e veçantë caktohet për shqyrtimin e kërkesave të veçanta procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit dhe/ose për shërbime të administratës gjyqësore.

Çfarë janë shpenzimet gjyqësore?

Janë shpenzimet e kryera në kuadër të procesit gjyqësor dhe të nevojshme për gjykimin (noterizimi apo lëshimi i dokumentacionit nga institucionet, marrja e dëshmisë nga dëshmitari, shpenzimet për ekspertët, përkthyesit, etj), përveç tarifës gjyqësore.

Çfarë është tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit?

Është tarifa që i parapaguhet shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror, për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv.

Çfarë është përjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore?

Është një formë e ndihmës juridike falas për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore.

Kush gëzon të drejtën e përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore:

Çdokush që ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar tarifat dhe shpenzimet gjyqësore apo i përket kategorive si më poshtë:

- viktimave të dhunës në familje;
- viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;
- viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin;
- fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

- personave me aftësi të kufizuara ose të verbrit;
- personave me probleme të shëndetit mendor;
- personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent.

Në këtë rast, Ju mund të përfitoni përjashtimin nga:

- pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta;
- pagimi i shpenzimeve gjyqësore;
- detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror.